



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

A.A.br.24/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Gjeriq, kryetare e koelgjit, Beshir Islami dhe Rrustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, lidhur me ankesën e subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit i Sjelljes së subjekteve politike, simpatizantëve dhe kandidatëve të tyre, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025, parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 145/2025 të datës 26.01.2025, në seancën e mbajtur më 03.02.2025 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, ushtruar kundër aktvendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 145/2025 të datës 26.01.2025.

A r s y e t i m

Me aktvendim të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 145/2025 datë 26.01.2025 është aprovuar si e bazuar ankesa e parashtruar më 23.01.2025 nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dhe subjekti politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë është dënuar me gjobë prej 6.000.00 (gjashtë mijë) euro për shkelje të Kodit të Sjelljes së subjekteve, simpatizantëve dhe kandidatëve të tyre, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09.02.2025. Subjekti politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, obligohet që shumën e përcaktuar monetare në emër të gjobës ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në afat ligjor, me propozim që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që do të marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe të zvogëlojë shumën në emër të gjobës së përcaktuar. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka paraqitur një përgjigje me shkrim ndaj ankesës, dhe

Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas të njëjtës më 01.02.2025 nxjerr Aktgjykimin AA. nr. 17/2025 me të cilin e ka refuzuar ankesën e parashtruar, si të pabazuar.

Në ndërkohë, Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar edhe një ankesë tjetër kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (KZAP) A. nr. 145/2025 i datës 26.01.2025. Ankesën e afatshme e ka parashtruar subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) përmes postës më 28.01.2025, me propozimin që e njëjta të aprovohet si i bazuar, kurse aktvendimi i ankimuar të prishet dhe të kthehet në rishqyrtim. Si arsye për parashtrimin e ankesës janë se duke krahasuar aktvendimin e lartpërmendur me aktvendimet tjera në situata të njëjta apo të ngjashme, është vërtetuar se Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) ka vepruar në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe ka shkelur parimin e objektivitetit dhe paanshmërisë dhe se i njëjti është i detyruar të zbatojë të njëjtin standard dhe praktikën ekzistuese.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) më 01.02.2025, në përgjigjen me shkrim ndaj ankesës së ushtruar kundër aktvendimit A.nr.145/2025 të datës 26.01.2025, i ka propozuar Gjykatës Supreme që ankesa e subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pabazuar ose të hidhet poshtë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, duke i marrë parasysh pretendimet e theksuara në përgjigjeën në ankesë, dhe pas këqyrjes së shkresave të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) A. nr. 145/2025, datë 26.01.2025 është e pabazuar.

Pas këqyrjes së shkresave të plota të lëndës, vërtetohet se Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (KQZ) më 23.01.2025 ka pranuar ankesë nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, në të cilën thuhet se subjekti politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, përkatësisht kandidati i saj për deputet Haxhi Avdyli në llogarinë e tij në Facebook ka postuar një video me tekstin përcjellës e cila është ende aktive, e realizuar në hapësirën e brendshme të Klinikës së Neurokirurgjisë, ku promovon numrin nga lista me të cilën kandidon për deputet, si person i cili në detyrë publike ka shfrytëzuar këto ambiente me qëllim të marrjes së votave. Në këtë mënyrë, janë shkelur dispozitat e nenit 36, pika 1 të ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet.

Pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, Paneli për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) vendosi si në dispozitiv të vendimit të kontestuar A. nr. 145/2025 të datës 26.01.2025. Në arsyetim të vendimit të tij, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) ndër të tjera ka theksuar se ankesa e parashtruar është e bazuar, sepse ka vërtetuar se subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, përkatësisht kandidati i tij për deputet ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 36, pika 1 të ligjit nr. 08/1-228 për zgjedhjet, si dhe shkelje

të rregullores zgjedhore 07/2024. Gjatë përcaktimit të lartësisë së shumës së gjobës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka marrë parasysh praktikën e deritashme b]në lëndët e ngjajshe apo të njëjta, si dhe rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimin e saj të mundshëm në procesin lëndor zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, më pas numrin e shkeljeve nga kandidatët e tij, fakti që janë tërhequr dy vende nga profili i kandidatit. Veprimet siç janë realizimi i video xhirimit dhe postimi i fotografisë për fushatën zgjedhore në ambientet e institucionit, në këtë rast Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjegjësisht në Klinikën e Neurokirurgjisë, paraqesin shkelje të legjislacionit zgjedhor.

Për bazën juridike të vendosjes si në dispozitiv të vendimit të kontestuar, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i është referuar nenit 36 paragrafi 1, nenit 118 paragrafi 1, nenit 120 paragrafit 1 nënparagrafi. 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (Ligji Nr. 08/L-228).

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, vlerëson se Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë nuk ka shkelur dispozitat e procedurës, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjithashtu edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë me rastin e përcaktimit të lartësisë së gjobës.

Gjykata Supreme në tërësi e pranon gjendjen faktike të konstatuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, në ankesë, si dhe në përgjigjen në ankesë, vërtetohet se janë provuar pretendimet e parashtruesit të ankesës – subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për faktin se subjekti politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) ka ndërmarrë veprime të ndaluara me legjislacionin pozitiv zgjedhor. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, të pabazuara janë pretendimet konkrete të theksuara në ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve të paanshmërisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit nga ana e Panelit Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtrësia (PZAP). Në përgjigjen e tij me shkrim ndaj ankesës së parashtruar, Paneli Zgjedhor për Parashtrësia dhe Parashtrësia (PZAP) ka renditur dhe në mënyrë shumë të detajuar ka paraqitur të gjitha rastet në të cilat është thirrur subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Rastet janë të ngjajshme por nuk janë të njëjta, dhe në tri rastet e përmendura subjekti politik është dënuar me gjobë në shumë me nga 4.000.00 (katër mijë) euro. Në këtë rast subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë është dënuar me gjobë në shumë prej 6.000.00 (gjashtë mijë) euro, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për shkeljet më të rënda nga dispozita e nenit 36, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (Ligji nr. 08/L-228), gjithashtu, vendimi i kontestuar është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës e cila ka vepruar sipas ankesës së subjektit politik Levizja Vetëvendosje (L VV) me seli në Prishtinë, dhe nga të gjitha që u parashtruan më lartë, Gjykata Supreme ka vendosur që vërtetohet vendimin e kontestuar.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat faktike të konstatuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), si dhe rrethanat specifike që kanë të bëjnë me lartësinë e gjobës, si dhe rrethanat tjera që kanë të bëjnë me rastet tjera të ngjajshme, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nuk ishte e nevojshme që të priset aktvendimi i ankimuar dhe as që i njëjti i ndryshohet.

Meqenëse nuk ka pretendime tjera ankimore, dhe për arsyet e lartpërmendura, dhe në pajtim me dispozitën e nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.24/2025, data 03.02.2025.

Kryetare e kolegjit - gjyqtare
Milena Gjeriq

Përktheu: Drita Kelmendi